



## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 29 shtator 2023

### Njoftim për shtyp

#### Rishikim i të dhënave në statistikën e jashtme për periudhën 2021 – 2022

Në pajtim me standardet e përshkruara ndërkombëtare dhe politikën për rishikim të të dhënave për statistikën e jashtme të publikuara në kuadër të Sqarimeve metodologjike, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut zbaton rishikimin e të dhënave të publikuara për statistikën e jashtme (bilanc pagesor, borxh/kërkesa të jashtme bruto dhe pozita e investimeve ndërkombëtare, si dhe zhvillimet të investimet direkte) në bazë të rregullt vjetore.

Rishikimi kryesisht vjen nga nevoja për kycjen e të dhënave të reja nga burimet e të dhënave të cilat mbledhen me dinamikë vjetore dhe me qëllim që të përmirësohet fushëveprimi dhe klasifikimi, domethënë të cilësisë së të dhënave të shfaqura.

Më konkretisht, rishikimi i të dhënave në pjesë më të madhe vjen nga:

- *Përfshirja e të dhënave nga pyetësorët vjetor për investimet në/nga jashtë për vitin 2022.*
- *Rishikimi i të dhënave për import dhe eksport të mallrave për vitin 2021, si rezultat i marrjes së të dhënave definitive për shkëmbimin e jashtëm tregtar të mallrave për vitin 2021.*
- *Kryqëzimi i kontrollimit të cilësisë nga burimet e përdorura, që sjell deri te ndryshime në shtrirjen e të dhënave dhe/ose riklasifikime shkaku i shtrirjes dhe cilësisë më të mirë të të dhënave për vitin 2022.*

#### **Bilanc i pagesave**

Rezultatet nga rishikimi i kryer për vitin 2022 tregojnë rritje të deficitit të llogarisë aktuale për 24,9 milionë euro, kështu që ai shënon 797,4 milionë euro. Shprehur përmes treguesve relativ, deficitin e llogarisë aktuale në raport me PBB-në për vitin 2022 pas rishikimit u rrit prej 6% në 6,2% (rritje prej 0,2 p.p.).

Këtë vit komponenta më e rëndësishme që vepron mbi rishikimin e llogarisë aktuale është **nënbilanci i mallrave**, që kontribuon për rritjen e deficitit tregtar për 28,2 milionë euro. Rishikimi më i rëndësishëm është bërë te punimet e ndërmjetësimit, shkaku i klasifikimit më të mirë të të dhënave.



## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Rishikimi i të dhënave të **nënbilancet e shërbimeve** dhe është në drejtim të rritjes së suficitit për 11,1 milionë euro, si rezultat i përfshirjes më të mirë dhe riklasifikimit të të dhënave nga qarkullimi pagesor burimor dhe nga deklaratat doganore. Ndryshimi më i madh i realizuar te shërbimet e transportit, në drejtim të rritjes së hyrjeve neto për 11,5 milionë euro.

Ndryshimi te nënbilanci i **hyrjeve primare** ndikonte në rritjen e deficitit për 10,4 milionë euro. Rishikimi është rezultat i ndryshimit të shumave të vlerësuara të fitimit të sapokrijuar me rezultatin financiar të realizuar, të cilat tregojnë dalje neto pak më të larta nga vlerësimet për 10,7 milionë euro. Rritja e daljeve vjen nga fitimit më i lartë i sapokrijuar për vitin 2022 te investimet direkte në vend për 20,2 milionë euro. Në drejtim të kundërt veprojnë investimet direkte jasht vendit, te të cilat ka rritje të hyrave për 9,5 milionë si rezultat i fitimit më të lartë të sapokrijuar nga ç'vlerësohet.

Efektet nga rishikimi mbi bilancin e pagesave në vitin 2021 dhe 2022.

(në milionë euro, në %)

|                                                                                                 | para rishikimit |               | pas rishikimit |               | Dallimet    | Dallimet     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|---------------|----------------|---------------|-------------|--------------|
|                                                                                                 | 2021            | 2022          | 2021           | 2022          | 2021        | 2022         |
| <b>I. Llogaritë rrjedhëse</b>                                                                   | <b>-366.4</b>   | <b>-772.4</b> | <b>-329.0</b>  | <b>-797.4</b> | <b>37.4</b> | <b>-24.9</b> |
| Mallra                                                                                          | -2,370.3        | -3,452.8      | -2,336.9       | -3,481.0      | 33.5        | -28.2        |
| Shërbime                                                                                        | 495.9           | 740.8         | 497.9          | 751.9         | 2.0         | 11.1         |
| Hyrje primare                                                                                   | -521.3          | -558.1        | -519.4         | -568.4        | 1.9         | -10.4        |
| Hyrje sekondare                                                                                 | 2,029.4         | 2,497.6       | 2,029.4        | 2,500.2       | 0.0         | 2.5          |
| <b>II. Llogaria kapitale, neto</b>                                                              | <b>7.1</b>      | <b>-3.6</b>   | <b>7.1</b>     | <b>0.0</b>    | <b>0.0</b>  | <b>3.6</b>   |
| <b>III. Llogaria financiare, neto</b>                                                           | <b>-297.3</b>   | <b>-719.1</b> | <b>-264.2</b>  | <b>-756.1</b> | <b>33.2</b> | <b>-37.0</b> |
| Investimet direkte, neto                                                                        | -387.5          | -670.2        | -387.5         | -654.2        | 0.0         | 16.0         |
| Investime të portofolit, neto                                                                   | -115.9          | -52.1         | -115.9         | -52.1         | 0.0         | 0.0          |
| Derivatet financiare (përveç rezervave)<br>dhe opcionet e të punësuarve për blerje të aksioneve | 0.0             | 0.0           | 0.0            | 0.0           | 0.0         | 0.0          |
| Investimet e tjera, neto                                                                        | -98.5           | -268.3        | -65.4          | -321.3        | 33.2        | -53.0        |
| Kapitali i mbetur vetanak                                                                       | -0.3            | -3.5          | -0.3           | -3.2          | 0.0         | 0.3          |
| Valuta dhe depozita                                                                             | 433.1           | 383.9         | 433.0          | 383.0         | -0.1        | -0.9         |
| Huamarrje                                                                                       | -248.9          | -366.4        | -248.9         | -372.7        | 0.0         | -6.3         |
| Sigurime, pensione dhe skema të garancioneve të standarizuara                                   | 0.0             | 0.0           | 0.0            | 0.0           | 0.0         | 0.0          |
| Kreditë tregtare dhe avanse                                                                     | -120.8          | -281.0        | -87.6          | -321.7        | 33.3        | -40.7        |
| Llogari të tjera për pagesë                                                                     | 1.9             | -0.7          | 1.9            | -5.7          | 0.0         | -5.0         |
| Të drejtat special të tërheqjes (Krijimi i detyrimit, neto)                                     | 163.4           | 0.7           | 163.4          | 1.0           | 0.0         | 0.4          |
| Rezervat devizore oficiale                                                                      | 304.7           | 271.6         | 304.7          | 271.6         | 0.0         | 0.0          |
| <b>Gabimet dhe lëshimet, neto</b>                                                               | <b>61.9</b>     | <b>57.0</b>   | <b>57.7</b>    | <b>41.3</b>   | <b>-4.2</b> | <b>-15.7</b> |

### Zëra memorandumi

|                                   |       |       |       |       |          |           |
|-----------------------------------|-------|-------|-------|-------|----------|-----------|
| Investime direkte të jashtme      | 83.0  | 83.6  | 83.0  | 90.8  | 0.0      | 7.2       |
| Investime direkte në vend         | 470.5 | 753.8 | 470.5 | 745.0 | 0.0      | -8.8      |
| Llogaritë rrjedhëse, % në PBB     | -3.1  | -6.0  | -2.8  | -6.2  | 0.3 p.p. | -0.2 p.p. |
| Balansi tregtar (f.o.b.) % në PBB | -20.3 | -26.8 | -20.0 | -27.0 | 0.3 p.p. | -0.2 p.p. |
| ID në vend % në PBB               | 4.0   | 5.8   | 4.0   | 5.8   | 0.0 p.p. | -0.1 p.p. |

Shënim: Në llogarinë financiare shenja (-) shënon hyrjet neto nga jasht. Te rezervat valutore shenja (+) shënon rritje, ndërsa shenja (-) shënon uljen e mjeteve valutore.

Burimi: BPRMV-ja, EshS-ja.



## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Me rishikimin, suficiti të **nënbilanci i të hyrave sekondare** është rritur për 2,5 milionë euro. Përfshirja e të dhënave për tatimin e arkëtuar/paguar nga investitorët gjatë transferimit të fitimit, të fituar nga pyetsori për investime në/nga jasht, ndikon në rritjen e hyrjeve neto për 5,9 milionë euro, kryesisht te sektori "shteti". Ndryshimet te komponentat tjera ndikuan në drejtim të kundërt.

Rishikimi i **llogarisë kapitale** rezulton me uljen e deficitit për 3,6 milionë euro, kryesisht shkaku i shtrirjes më të mirë të të dhënave në burimet.

Hyrjet neto në **llogarinë financiare**, pas rishikimit të kryer, janë rritur për 37 milionë euro, në pjesë më të madhe si rezultat i rritjes së detyrimeve neto në bazë të kredive tregtare (për 40,7 milionë euro), ndërsa detyrimet neto në bazë të investimeve direkte janë ulur për 16 milionë euro.

Në kuadër të kategorisë **investime direkte**, ndryshimi i rezultatit të përfshirjes së të dhënave nga pyetsori vjetor me të cilin zëvendësohet shumat e vlerësuara të fitimit të sapokrijuar dhe dividendave të llogaritura, si dhe kryqëzimet e cilësisë së të dhënave. Si rezultat i kësaj, detyrimet neto janë ulur për 15 milionë euro, ndërsa mjetet neto janë rritur për 0,9 milionë euro. *Detyrimet neto në bazë të investimeve direkte* kryesisht dalin nga kategoria borxh ndërkompani për 55,3 milionë euro, por edhe nga ndryshimet te kapitali vetanak, ku detyrimet neto janë ulur për 2,2 milionë euro. Ndryshimet në riinvestimin e fitimit kishin ndikim të kundërt, pra shkaktuan rritje të detyrimeve për 42,5 milionë euro.

Analizuar sipas drejtimit të investimeve, investimet direkte në vend, pas rishikimit, shënojnë ulje për 8,8 milionë euro, ku pjesëmarrja e tyre në PBB-në u ul për 0,1 p.p..

Në kuadër të investimeve tjera, rishikim më të rëndësishëm shënojnë **kreditë tregtare** me rritje të detyrimeve neto për 40,7 milionë euro, si rezultat i shpërndarjes më të mirë të kredive afatshkurtë tregtare ndërmjet subjekteve të lidhura dhe jo të lidhura, si dhe përfshirje më të mirë të të dhënave në qarkullimin pagesor. Detyrimet neto në bazë të **kredive** janë rritur për 6,3 milionë euro.

Pas rishikimit, **gabimet dhe lëshimet në bilancin e pagesave janë ulur për 15,7 milionë euro** dhe shënojnë 41,3 milionë euro (me parashenjë pozitive).

*Deficiti i llogarisë aktuale për vitin 2021 arrin 329 milionë euro, pra shënon rënie prej 37,4 milionë euro, ku treguesi bilanc i llogarisë aktuale në raport me PBB-në është ulur prej 3,1% në 2,8% (rënie prej 0,3 p.p.).*

Arsyeja kryesore e auditimit të vitit 2021 është përfshirja e të dhënave definitive për shkëmbimin e jashtëm tregtar për vitin 2021 të marra nga Drejtoria e Doganave të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Auditimi ka vepruar në drejtim të reduktimit të deficitit nga shkëmbimi mallrave për 33,5 milionë euro dhe rritje të suficitit të shkëmbimi i mallrave për 2 milionë euro. Kjo vepronte për uljen e detyrimeve në bazë të kredive tregtare për 33,3 milionë euro.



## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Gabimet dhe lëshimet në bilancin e pagesave janë ulur për 4,2 milionë euro dhe shënojnë 57,7 milionë euro (me parashenjë pozitive).

### ***Borxhi i jashtëm bruto, kërkesa të jashtme bruto dhe borxhi i jashtëm neto***

Auditimi vjetor i të dhënave çoi në ulje të gjendjes së borxhit të jashtëm bruto dhe të kërkesave të jashtme bruto (për 65,8 milionë euro dhe 28,9 milionë euro, përkatësisht), që çoi në ulje të kërkesave të jashtme bruto për 36,9 milionë euro. Treguesi relativ , borxhi i jashtëm bruto i shprehur si përqindje nga PBB-ja, për vitin 2022, pas auditimit arrin 83,7 %, që paraqet rënie prej 0,5 p.p., ndërsa kërkesat e jashtme bruto arrijnë 50,2% nga PBB-ja, që paraqet ulje për 0,2 p.p..

Në anën e borxhit të jashtëm bruto, analizuar sipas sektorëve, auditimi u reflektua me uljen e borxhit ndërkompanive (për 37,1 milionë euro), të detyrimeve të sektoreve tjera (për 28,3 milionë euro) dhe te sektori "shteti" (për 0,8 milionë euro), gjatë rritjes së detyrimeve te banka qendrore (për 0,4 milionë euro).

Efektet nga auditimit mbi borxhin, kërkesa dhe borxhi neto në vitin 2022  
(në milionë euro, në %)

| Sektori i rezidentëve                                             | Borxhi i jashtëm bruto |                 |              | Kërkesat e jashtme bruto |                |              | Borxhi i jashtëm neto |                |              |
|-------------------------------------------------------------------|------------------------|-----------------|--------------|--------------------------|----------------|--------------|-----------------------|----------------|--------------|
|                                                                   | Para rishikimit        | Pas rishikimit  | Dallimi      | Para rishikimit          | Pas rishikimit | Dallimi      | Para rishikimit       | Pas rishikimit | Dallimi      |
| 1. SHTETI                                                         | 3,432.2                | 3,431.5         | -0.8         | 0.0                      | 0.0            | 0.0          | 3,432.2               | 3,431.5        | -0.8         |
| 2. BANKA QENDRORE                                                 | 694.9                  | 695.2           | 0.4          | 3,631.1                  | 3,631.1        | 0.0          | -2,936.3              | -2,935.9       | 0.4          |
| 3. INSTITUCIONET DEPOZITARE, përveç bankës qendrore               | 957.7                  | 957.7           | 0.0          | 733.5                    | 733.5          | 0.0          | 224.2                 | 224.2          | 0.0          |
| 4. SEKTORËT E TJERË                                               | 2,824.4                | 2,796.1         | -28.3        | 1,316.8                  | 1,298.2        | -18.5        | 1,507.7               | 1,497.9        | -9.7         |
| 5. INVESTIMET DIREKTE: Kredi ndërmjet ndërmarrjeve të ndërlidhura | 2,946.6                | 2,909.4         | -37.1        | 825.7                    | 815.4          | -10.3        | 2,120.8               | 2,094.0        | -26.8        |
| <b>BORXHI I JASHTËM BRUTO</b>                                     | <b>10,855.8</b>        | <b>10,790.0</b> | <b>-65.8</b> | <b>6,507.1</b>           | <b>6,478.3</b> | <b>-28.9</b> | <b>4,348.6</b>        | <b>4,311.7</b> | <b>-36.9</b> |
| <b>BORXHI I JASHTËM BRUTO % PREJ PBB</b>                          | <b>84.2</b>            | <b>83.7</b>     | <b>-0.5</b>  | <b>50.5</b>              | <b>50.2</b>    | <b>-0.2</b>  | <b>33.7</b>           | <b>33.4</b>    | <b>-0.3</b>  |

Burimi: BPRMV-ja, EshS-ja.

Në anën e kërkesave të jashtme bruto, ndryshim më të madh me auditimin ka te të dhënat për sektorët tjerë, të cilat janë ulur për 18,5 milionë euro, derisa kërkesat e ndërkompanive për 10,3 milionë euro.

Këto ndryshime sollën deri në ulje të borxhit të jashtëm neto për vitin 2022 për 36,9 milionë euro, kryesisht si rezultat i borxhit ndërkompanive për 26,8 milionë euro dhe të sektorëve tjerë për 9,7 milionë euro.

### ***Pozita e Investimeve Ndërkombëtare***

Auditimi i të dhënave në raportin për PIN-in, përveç ndryshimeve të instrumenteve të borxhit, e përfshirë në raportet për borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesave të jashtme bruto, përfshijnë



## **Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë**

ndryshime edhe te instrumentet vetanake, kryesisht në kuadër të zërat e investimeve direkte dhe të portofolit. Auditimi te instrumentet vetanake vjen nga nevoja për shkëmbimin e të dhënave të vlerësuara primare të cilat publikohen me dinamikë tremujore me të dhënat nga pyetsorët vjetor për investimet në dhe nga jasht.

*Pas auditimit, PIN-i negativ, neto, u ul për 3 milionë euro dhe arriti në 8,147.8 milionë euro, pra treguesi relativ PIN, neto, si % e PBB-së mbeti në të njëjtin nivel prej 63.2%. Zvogëlimi i PIN-it negativ, neto, rezulton nga rënia e detyrimeve për 42.8 milionë euro, me një rënie të njëkohshme të mjeteve për 39.8 milionë euro.*

Në anën e mjeteve, auditim në rënie shënojnë investimet direkte (për 24,1 milionë euro), kreditë tregtare (për 15,7 milionë euro) dhe huamarrjet (për 2,8 milionë euro), ndërsa kapitali i mbetur vetanak është rritur për 2,9 milionë euro. Rënia e investimeve direkte rezulton pothuajse e barabartë nga rënia e kapitalit vetanak (për 13.7 milionë euro) dhe e instrumenteve të borxhit (për 10.3 milionë euro).

Nga ana e detyrimeve, rënia vjen nga kreditë tregtare (për 18.2 milionë euro), kreditë (për 15.1 milionë euro), investimet direkte (për 11.3 milionë euro) dhe investimet e portofolit (për 3.5 milionë euro), ndërsa pjesa tjetër e llogarive pagesore shënuan rritje (për 5 milionë euro). Rënia e investimeve direkte në tërësi vjen nga borxhi ndërkompanive (për 37.1 milionë euro), ndërsa kapitali vetanak është rritur (për 25.8 milionë euro).

Investimet direkte, neto, janë rritur për 12,8 milionë euro si rezultat i rritjes te kapitali vetanak, derisa borxhi ndërkompani shënon rënie neto.



## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Efektet nga auditimit mbi PIN-in në vitin 2022  
(në milionë euro, në %)

|                                                                                              | 2022            |                 |              |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|-----------------|--------------|
|                                                                                              | Para rishikimit | Pas rishikimit  | Dallimet     |
| <b>PIN-neto</b>                                                                              | <b>-8,150.8</b> | <b>-8,147.8</b> | <b>3.0</b>   |
| Mjetet                                                                                       | 7,687.9         | 7,648.1         | -39.8        |
| Detyrimet                                                                                    | 15,838.7        | 15,795.9        | -42.8        |
| <i>Sektorët</i>                                                                              |                 |                 |              |
| PIN,sheti-neto                                                                               | -3,425.8        | -3,425.0        | 0.8          |
| PIN, banka qendrore neto                                                                     | 3,313.4         | 3,313.0         | -0.4         |
| PIN, institucionet depozitare neto përveç bankës qendrore                                    | -1,245.2        | -1,330.0        | -84.8        |
| PIN, sektorët e tjerë neto                                                                   | -6,793.1        | -6,705.7        | 87.4         |
| <b>Mjetet</b>                                                                                | <b>7,687.9</b>  | <b>7,648.1</b>  | <b>-39.8</b> |
| Investimet direkte                                                                           | 1,020.3         | 996.2           | -24.1        |
| Investime të portofolit                                                                      | 695.3           | 695.3           | 0.0          |
| Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opcionet e të punësuarve për blerje të aksioneve | 0.0             | 0.0             | 0.0          |
| Kapitali i mbetur vetanak                                                                    | 3.1             | 6.0             | 2.9          |
| Valuta dhe depozita                                                                          | 653.5           | 653.5           | 0.0          |
| Huamarrje                                                                                    | 224.4           | 221.6           | -2.8         |
| Sigurime, pensione dhe skema të garancioneve të standarizuara                                | 0.0             | 0.0             | 0.0          |
| Kreditë tregtare dhe avanse                                                                  | 1,228.2         | 1,212.4         | -15.7        |
| Llogari të tjera për pagesë                                                                  | 0.3             | 0.3             | 0.0          |
| Rezervat devizore                                                                            | 3,862.9         | 3,862.9         | 0.0          |
| <b>Detyrimet</b>                                                                             | <b>15,838.7</b> | <b>15,795.9</b> | <b>-42.8</b> |
| Investimet direkte                                                                           | 7,864.9         | 7,853.6         | -11.3        |
| Investime të portofolit                                                                      | 2,110.2         | 2,106.7         | -3.5         |
| Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opcionet e të punësuarve për blerje të aksioneve | 0.0             | 0.0             | 0.0          |
| Kapitali i mbetur vetanak                                                                    | 3.4             | 3.3             | 0.0          |
| Valuta dhe depozita                                                                          | 471.0           | 471.0           | 0.0          |
| Huamarrje                                                                                    | 4,058.4         | 4,043.3         | -15.1        |
| Sigurime, pensione dhe skema të garancioneve të standarizuara                                | 0.0             | 0.0             | 0.0          |
| Kreditë tregtare dhe avanse                                                                  | 1,080.7         | 1,062.6         | -18.2        |
| Llogari të tjera për pagesë                                                                  | 0.0             | 5.0             | 5.0          |
| Të drejtat special të tërheqjes (Krijimi i detyrimit,neto)                                   | 250.1           | 250.5           | 0.4          |
| <b>PIN-neto/PBB (%)</b>                                                                      | <b>-63.2</b>    | <b>-63.2</b>    | <b>0.0</b>   |

Burimi: BPRMV-ja, EShS-ja.



**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut**  
**Drejtoria për Statistikë**

***Informacione shoqëruese***

Të dhënat të serive kohore dhe sqarime metodologjike:

[http://www.nbrm.mk/eksterni\\_statistiki-al.nspix](http://www.nbrm.mk/eksterni_statistiki-al.nspix)

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave:

[http://www.nbrm.mk/kalendar\\_na\\_objavuvanje\\_na\\_podatoci-al.nspix](http://www.nbrm.mk/kalendar_na_objavuvanje_na_podatoci-al.nspix)

Për pyetje nga mediat, ju lutemi kontaktoni personat përgjegjës nga Kabineti i guverntores.

Për informata më të detajuara lidhur me të dhënat statistikore të publikuara, mund të na kontaktoni në [contact.statistika@nbrm.mk](mailto:contact.statistika@nbrm.mk) ose në telefon 02 3215 181 lokal 103 (ose 110/108).